

## LIGJI PËR KRYQIN E KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

(“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.41/94, 7/97,21/98 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/19)

### I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

Me këtë ligj rregullohet pozita dhe detyrat e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë, përdorimi dhe mbrojtja e ëmblesës dhe emri i Kryqit të Kuq dhe mënyra e financimit të detyrave të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Kryqi i Kuq).

#### Neni 2

Kryqi i Kuq është organizatë vullnetare, masovike, e pavarur dhe humanitare e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Kryqi i Kuq është organizatë joqeveritare dhe jashtëpartiake.

Kryqi i Kuq realizon qëllime dhe detyra të caktuara humanitare nga fusha e shëndetësisë, mbrojtja sociale dhe edukimi, mbi parimet e humanizmit dhe solidaritetit.

Detyrat e paragrafit 3 të këtij neni janë me interes publik dhe Kryqi i Kuq i zbaton si autorizime publike.

#### Neni 3

Kryqi i Kuq është organizatë e vetme e Kryqit të Kuq në teritorin e Republikës së Maqedonisë, të cilin e përbëjnë organizatat e Kryqit të Kuq të komunave dhe qytetit të Shkup.

Organizimi, rrethi i punës dhe mënyra e punës së organeve dhe shërbimeve nëpërmjet të cilave Kryqi i Kuq i zbaton detyrat, numrin, mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve të organeve dhe shërbimeve rregullohet me Statutin e Kryqit të Kuq.

#### Член 4

Kryqi i Kuq qëllimet dhe detyrat e veta i realizon, në bazë të humanitetit, paanshmërisë, neutralitetit, pavarësisë, vullnetarizmit, bashkimit dhe universalitetit, si parime fundamentale të lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

#### Neni 5

Kryqi i Kuq bashkëpunon me Komitetin ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, Federata ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, shoqatave nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe me organizata tjera ndërkombëtare humanitare, shëndetësore dhe sociale.

#### Neni 6

Kryqi i Kuq ka cilësinë e personit juridik.

Selia e Kryqit të Kuq është në Shkup.

## II. PËRDORIMI DHE MBROJTJA E ËMBLEMËS DHE EMRIT TË KRYQIT TË KUQ

#### Neni 7

Ëmblema e Kryqit të Kuq është Kryqi i kuq me pesë katrorë të njejtë në sipërfaqe të bardhë.

#### Neni 8

Askush nuk guxon ta përdorë ëmblemën dhe emrin kryqi i kuq nëse sipas dispozitave të këtij ligji dhe konvetave të Gjenevës nuk ka të drejtë ta përdorë ëmblemën, gjegjësisht emrin kryqi i kuq.

Ëmblema kryqi i kuq mund të përdoret si ëmblemë e theksimit, si ëmblemë e përkatësisë dhe si ëmblemë për mbrojtje, në pajtueshmëri me konventat e Gjenevës, në rastet dhe në kushte të caktuara me këtë ligj.

#### Neni 9

Vetëm Kryqi i Kuq ka të drejtë në emrin Kryqi i Kuq.

#### Neni 10

Në paqe me ëmblemën e Kryqit të Kuq mund të shënohen:

- 1) ndërtesa, pajisje, materiale sanitare dhe mjete transportuese dhe bartëse të organizatave, gjegjësisht entet nga fusha e shëndetësisë dhe organizatave, gjegjësisht entet në fushën e mbrojtjes sociale për strehimin e personave të cilët kanë nevojë kujdes të përhershëm mjekësor (në tekstin e mëtejme: organizata shëndetësore);
- 2) mjete për transport apo bartje të organizatave tjera që përdoren për bartjen e personave të plagosur apo të sëmurë, nëse për shfrytëzimin e ëmblemës së kryqit të kuq marrin leje nga Kryqi i Kuq dhe
- 3) vende të caktuara për dhënien e ndihmës së parë mjekësore në vendet e banuara, në trafik, në ndërmarrje dhe në persona tjerë juridik, si dhe vende ku janë vendosur materiale dhe pajisje sanitare që shërbejnë për shënien e ndihmës së parë mjekësore.

#### Neni 11

Në paqe dhe në situata të jashtëzakonshme dhe në luftë ëmblemën e kryqit të kuq mund ta shfrytëzojnë, gjegjësisht të jenë të theksuara si me ëmblemë e përkatësisë;

- 1) punëtorë, ndërtesa, mjete dhe materiale të Kryqit të Kuq; dhe
- 2) personeli, mjete dhe materiale të shoqatave të huaja nacionale të Kryqit të Kuq, gjetë kohës kur në Republikën e Maqedonisë, pas miratimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë kryejnë veprat e Kryqit të Kuq.

Në situata të jashtëzakonshme dhe në luftë, ëmblemën e përkatësisë të cilën e përdorin organizatat dhe personat nga paragrafi 1 të këtij neni patjetër duhet të jetë me përmasa më të vogla se ëmblema e mbrojtjes dhe nuk guxon të vendoset trakë rreth dorës, mbi kulmin e ndërtesës dhe në mjete për transport.

#### Neni 12

Në paqe dhe në situatë të jashtëzakonshme dhe në luftë ëmblema e kryqit të kuq mund të përdoret gjegjësisht të mbahet si ëmblemë për theksim dhe si ëmblemë për mbrojtjen e personave, në njësitë sanitare dhe entet, ndërtesat, pajisjet, materialet sanitare dhe në mjetet për transport dhe bartje (në tokë, në ujë dhe në fluturime) që i përkasin shërbimit sanitar të forcave të armatosura të Republikës së maqedonisë.

Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni kanë të bëjnë edhe me shërbimin sanitartë forcave të armatosura të shteteve tjera gjatë kohës kur në territorin e Republikës së Maqedonisë, në bazë të miratimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kryen veprimtari sanitare.

### Neni 13

Në situatat të jashtëzakonshme dhe në gjendje lufte ëmblema e kryqit të kuq përdoret, gjegjësisht mbahet si ëmblemë për mbrojtje në:

- 1) ndërtesa, pajisje, materiale sanitare, mjete për transport dhe bartje dhe punëtorë në organizata pune;
- 2) ndërtesa, pajisje, materiale sanitare, mjete për transport dhe bartje të Kryqit të Kuq dhe të personave të caktuar për gjetje, grumbullim, bartje dhe kujdes për të plagosurit dhe të sëmurë apo për parandalimin e sëmundjeve;
- 3) njësi të mbrojtjes civile për dhënien e ndihmës së parë mjekësore;
- 4) anije për mjekim;
- 5) ekipe për dhënien e ndihmës së parë mjekësore të cilat i organizojnë organizatat shëndetësore, ente dhe ndërmarrje tjera dhe Kryqi i Kuq gjatë kohës përderisa i kryejnë ato punë dhe
- 6) mjete në komunikacionin tokësor, ujor dhe ajror që shërbejnë për bartjen e të plagosurve, të sëmureve dhe materialeve sanitare (transport sanitar).

Pas përjashtimit nga dispozitat e paragrafit 1të këtij neni, organi kompetent i drejtorisë mund ta kufizojë përdorimin, gjegjësisht mbajtjen e ëmblemës së Kryqit të kuqsi ëmblemë për mbrojtjen e ndërtesave dhe pajisjeve të caktuara, mjeteve transportuese dhe bartëse dhe për personat të atij paragrafi nëse atë e kërkojnë interesat e caktuara të mbrojtjes dhe sigurisë.

Në situata të jashtëzakonshme dhe gjatë luftës ëmblema e kryqit të kuq mund të përdoret, gjegjësisht të mbahet si ëmblemë e mbrojtjes së personelit, ndërtesave, pajisjeve, materialeve sanitare dhe të mjeteve transportuese dhe bartëse në përbërjen e shërbimeve sanitare të organizatave të huaja të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe organizatave tjera të huaja vullnetare për ndihmë, kur pas miratimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në territorin e Republikës së Maqedonisë kryejnë veprimtari sanitare.

### Neni 14

Në situata të jashtëzakonshme dhe në luftë ëmblema e Kryqit të kuq mund të përdoret si ëmblemë e theksimit dhe si ëmblemë për mbrojtjen e zonave dhe vendeve sanitare të caktuara për shkak të mbrojtjes së të plagosurve dhe të sëmurëve, si dhe për personat të cilët punojnë për kujdesin e kurimin e të plagosurve dhe të sëmurëve në ato zona dhe vende të cilët qëndrojnë aty.

Zonat dhe vendet sanitare të paragrafit 1 të këtij neni i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë

#### Neni 15

Personat e nenit 13 të këtij ligji, të cilët kanë të drejtë të mbajnë ëmblemën e kryqit të kuq, në situatë të jashtëzakonshme dhe në luftë patjetër duhet të kenë legjitimacion me fotografimin e vet dhe me vulë të thatë, që shërben si dëshmi se punojnë në organizata të caktuara, gjegjësisht ente dhe në cilësi të caktuar. Në legjitimacione patjetër duhet të theksohen detyrat të cilat i kryejnë ata.

#### Neni 16

Personat e nenit 8 të këtij ligji përderisa janë në shërbim, patjetër me vet duhet ta kenë legjitimacionin e nenit 15 të këtij ligji dhe në dorën e majtë të mbajnë shiritin me ëmblemën e kryqit të kuq dhe me vulë e cila është rrezistuese në lagështi.

Personi i cili do ta humbë cilësinë në bazë të së cilës ka marë legjitimacionin dhe shiritin me ëmblemën me kryq të kuq, është i obliguar t'ia kthejë legjitimacionin dhe shiritin organit i cili ia ka dhënë legjitimacionin, gjegjësisht shiritin.

#### Neni 17

Organi kompetent i drejtorisë ia jep legjitimacionin të nenit 15 dhe shiritin e nenit 16 të këtij ligji personave të caktuar në rast të situatave të jashtëzakonshme dhe në luftë dhe për këtë të mbajë evidencë.

#### Neni 18

Transporti sanitar, organizatat dhe njësitë, materialet sanitare, pajisjet dhe mjetet transportuese dhe për bartje të nenit 13 të këtij ligji, si dhe zonat e vendet sanitare të nenit 14 të këtij ligji, nëse në situata të jashtëzakonshme dhe në luftë për ata përdoret ëmblema kryqi i kuq si ëmblemë për mbrojtje, patjetër duhet të jenë të theksuara me ëmblemën e kryqit të kuq në mënyrë që të mund të shihet dhe në vaend të caktuar.

### III. DETYRAT E KRYQIT TË KUQ

#### Neni 19

Kryqi i Kuq:

1. Organizon grumbullimin e ndihmës së organeve shtetërore, ndërmarrjeve dhe donatorëve tjerë në Republikën e Maqedonisë që e jep për lehtësimin dhe mënjanimin e pasojave nga

fatkeqësitë elementare, epidemive apo konflikteve të armatosura dhe e shpërndan në vend dhe e dërgon jashtë vendit;

2. Merr pjesë në shpërndarjen e ndihmës humanitare të pranuar nga shoqatat nacionale, Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Federatën ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe nga organizata tjera humanitare ndërkombëtare dhe nacionale;

3. Bashkëpunon me shërbimin shëndetësor, Shërbimin sanitar të Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe njësitë dhe selitë e Mbrojtjes civile në përkujdesjen e të lënduarve dhe të sëmurëve në rast lufte apo fatkeqësivemasovike elementare;

4. Bashkëpunon me organet shtetërore në pranimin dhe vendqëndrimin e popullatës së evakuuar dhe në zbatimin e masave. Për kujdesjen e popullatës së pësuar dhe rrezikuar;

5. I kryen detyrat të cilat dalin nga dispozitat e Konventës së Gjenevës për përmirësimin e pozitës së të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në luftë, Konventës së Gjenevës për përmirësimin e pozitës së të plagosurve, të sëmurëve dhe shkatërruesit e anijeve të forcave të armatosura në dete dhe Konventës së Gjenevës për mbrojtjen e qytetarëve gjatë luftës prej 12 gusht të vitit 1949 dhe Protokolet plotësuese të cilat Konventat e Gjenevës I dhe II prej 10 qershor të vitit 1977 dhe obligimet tjera ndërkombëtare të cilat i ndërmerr Republika e Maqedonisë në këtë lëmi;

6. Grumbullon, rregullon dhe jep të dhëna për viktimat e fatkeqësive masovike – elementare dhe konflikteve të armatosura;

7. E organizon dhe udhëheq punën e Shërbimit për kërkim;

8. Organizon ekipe dhe njësi për intervenim në rast të fatkeqësive masovike elementare;

9. Merr pjesë në organizimin dhe dhënien e ndihmës sociale – elementare dhe mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve në rast të fatkeqësive elementare, epidemive dhe fatkeqësive tjera më të mëdha apo luftë;

10. Merr pjesë në pollarizimin e dhurimit të gjakut dhe i organizon aksionet për dhurim vullnetar të gjakut, në kushte paqeje dhe të jashtëzakonshme;

11. Merr pjesë në edukimin shëndetësor të popullatës dhe merr pjesë në organizimin e më shumë vëllimeve të ndihmës mes veti të qytetarëve në shpirtin e humanizmit dhe solidaritetit;

12. Merr pjesë në aftësimin e popullatës për dhënien e ndihmës së parë mjekësore;

13. I aftëson qytetarët për kujdesjen e të sëmurëve në kushte shtëpiake dhe organizon shërbime dhe aftëson kuadro për këtë veprimtari;

14. Aftëson kuadro për siguri në ujë dhe merr pjesë në organizimin e sigurisë në ujë në rajonet turistike dhe objekte tjera me ujë;

15. Aftëson kuadro për siguri në oyje dhe merr pjesë në dhënien e ndihmës së parë mjekësore në pyje dhe

16. Kryen edhe detyra tjera të caktuara me ligj.

#### Neni 20

Në rast të fatkeqësive masovike elementare, epidemi, fatkeqësi tjera më të mëdha apo luftë, Kryqi i Kuq në kryerjen e detyrave të veta ka të drejtë prioritare në transportin e personave dhe materialeve të gjitha mjeteve të trafikut publik dhe të drejtë në shpalljen e lajmeve dhe kumtesave, nëpërmjet mjeteve për informim publik.

#### Neni 21

Në kryerjen e detyrave të përcaktuara me nenin 19 të këtij ligji, Kryqi i Kuq bashkëpunon me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, ministritë kompetente, Fondin për sigurim shëndetësor, Fondin për sigurim pensional dhe invalidor, Fondin për rrugë, Shërbimi sanitar i Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe njësitë dhe selitë e mbrojtjes civile, shërbimi shëndetësor dhe social, me ndërmarrjet dhe organe e organizata tjera.

Organet dhe organizatat e paragrafit 1 të këtij neni në kuadër të rrethit të punës dhe autorizimeve Kryqit të Kuq i sigurojnë ndihmë financiare dhe ndihma tjera, për shkak të kryerjes me sukses të qëllimeve dhe detyrave të veta programore.

### IV. SHËRBIMI PËR KËRKIM

#### Neni 22

Kryqi i Kuq formon Shërbimin për kërkim, për shkak të kryerjes së detyrave të caktuara me nenin 19 paragrafi 1 pikat 5 dhe 6 të këtij ligji.

#### Neni 23

Organizimi dhe mënyra e punës së Shërbimit për kërkim rregullohet me akt të Kryqit të Kuq, të cilit pajtueshmëri i jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

## Neni 24

Kryqi i Kuq mund të japë shërbime për vendqëndrim dhe ushqim edhe për nevojat tjera të personave të cilët kanë nevojë për ndihmë të tillë për shkaqe sociale, shëndetësore dhe të tjera dhe të organizojnë ushqim në rast të situatave ë jashtëzakonshme.

Kryqi i Kuq mund të themelojë organizatë për dhënien e shërbimeve të paragrafit 1 të këtij neni.

Dhënia e shërbimeve për vendqëndrimin dhe ushqimin e paragrafit 1 të këtij neni, nuk llogariten për veprimtari restoraneshe.

## Neni 25

Kryqi i Kuq, gjatë kryerjes së detyrave të përmendura në nenin 19 të këtij ligji, mban librin e regjistrit, një dosje dhe lëshon çertifikata, lista dhe dokumente tjera.

## V. FINANCIMI I KRYQIT TË KUQ

### Neni 26

Kryqi i Kuq realizon burimet financiare nga:

- Kuota e anëtarësisë,
- Tarifat e përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër,
- Dhuratat dhe trashëgimit,
- Kontributet vullnetare,
- Qiratë

Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxheti i komunave, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit,

- donacione dhe sponsorizime
- aktivitete fitimprurëse të cilat përdoren për qëllimet dhe detyrat të përcaktuara nga Statusi,
- të ardhurat nga investimet, dividendët, kamatat dhe huazimet,
- veprimtari të shërbimit në lidhje me funksionin e Kryqit të Kuq dhe
- të holla dhe të ardhura të tjera të përcaktuara me ligj.

## Neni 27

Në favor të Kryqit të Kuq, tarifat paguhen:

- 3% të çmimit të biletës për ngjarje kulturore dhe argëtuese, koncerte dhe festivale dhe manifestimeve të panairit të karakterit ndërkombëtar dhe shtetëror përveç koncerteve të karakterit humanitar, performanca teatrale, ekspozitë e pikturave, skulpturave dhe performancave tjera të organizuara nga nxënësit e shkollave dhe studentëve të univerziteteve.
- 3% të çmimit për secilën biletë për garat sportive, përveç sporteve amatore dhe
- kompensim për regjistrimin e automjeteve

Baza e pagesës së tarifës nga paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij neni është çmimi i biletës për hyrje.

Fondet e mbledhura nga paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij neni, paguhen jo më vonë se 30 ditë nga dita e ngjarjes në llogari të Kryqit të Kuq.

Kryqi i Kuq me një akt të veçantë përcakton mënyrën e shpërndarjes së fondeve të mbledhura nga paragrafi 1 i këtij neni.

## Neni 27-a

Shuma e pagesës nga neni 27 paragrafi 1 pika 3 të këtij ligji, që paguhet për Kryqin e Kuq nga personat vendas juridik dhe fizik gjatë regjistrimit të automjeteve, është si më poshtë:

1) motoçikleta, triçikleta dhe katërçikleta:

- deri në 100 cm<sup>3</sup> tarifë 15,00 denarë,
- nga 101 cm<sup>3</sup>-250 cm<sup>3</sup> tarifë nga 20,00 denarë,
- nga 251 cm<sup>3</sup>-750 cm<sup>3</sup> tarifë nga 40,00 denarë,
- mbi 751 cm<sup>3</sup> tarifë nga 65,00 denarë.

2) automjetet për pasagjerë

- deri në 33 kW tarifë nga 70,00 denarë,
- prej 33,1 kW-55 kW tarifë nga 95,00 denarë,
- prej 55,1 kW-84 kW tarifë nga 110,00 denarë,
- prej 84,1 kW-150 kW tarifë nga 120,00 denarë,
- mbi 150 kW tarifë nga 130,00 denarë.

3) kamionë

- kapaciteti i ngarkesës deri në 3,5 t tarifë prej 215,00 denarë,
- kapaciteti i ngarkesës nga 3,6 t – 10 t tarifë prej 360,00 denarë,
- kapaciteti i ngarkesës mbi 10,1 t tarifë prej 470,00 denarë.

4) automjete pune/traktorë

- tarifë prej 80,00 denarë.

5) autobusë të destinuar për:

-trafiku ndërkomunal dhe trafiku ndërkombëtarj,tarifë prej 330,00 denarë dhe  
- trafiku I qytetit dhe i periferisëj, tarifë prej 240,00 denarë.

6) automjete tërheqëse

- tarifë prej 350,00 denarë.

7) automjete speciale

- tarifë prej 80,00 denarë dhe

8) mjetet lidhëse

- tarifë prej 190,00 denarë.

Obligues për pagimin e tarifës nga paragrafi 1 i këtij neni, është personi juridik ose fizik në emrin e të cilit është regjistruar automjeti.

Tarifën nga paragrafi 1 të këtij neni, nga personi juridik ose fizik, në emrin e të cilit është regjistruar automjeti paguhet nga ana e personit juridik i autorizuar për kryerjen kontrollimit teknik, gjatë pagesës së kontrollës teknike, ndërsa pagesa argumentohet gjatë regjistrimit të automjetit.

Personi juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik kryen pagesën nga paragrafi 3 të këtij neni jo më vonë se 15 ditë të muajit aktual për muajin e kaluar për llogarin e Kryqit të Kuq.

Personi juridik i autorizuar për kryerjen e kontrollit teknik nga paragrafi 3 i këtij neni, dorëzon raport mujor deri te Kryqi i Kuq, i cili përmban të dhëna për numrin e automjeteve sipas kategorive në të cilat është kryer kontrollimi teknik, për kompensimin sipas kategorive të automjeteve si dhe për kompensimin e përgjithshëm.

## Neni 28

Gjatë aksioneve dhe manifestimeve tradicionale: "Java e luftës kundër kancerit", "Java e Kryqit tëKuq", "Java kundër luftës të SIDËS" , "Java e luftës kundër sëmundjeve të gjirit dhe tuberkulozës" dhe "Java e luftës kundër urisë" dorëzohen argumente shtesë. Gjatë aksioneve dhe manifestimeve tradicionale: "Java e kancerit", "Java e Kryqit të Kuq", "Java e SIDA", "Lufta kundër sëmundjeve të gjirit dhe tuberkulozit" dhe "Java e urisë" lëshohen pullat shtesë. Lëshimi, shpërndarja, shitja dhe llogaritja e pullave të taksave kryhet nga Shoqata akcionare për trafikun postal "Posta e Maqedonisë" – në pronësi të shtetit – Shkup, në përputhje me ligjin.

Gjatë kohëzgjatjes së veprimeve dhe manifestimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në favor të Kryqit të Kuq, bëhet pagesë prej 30% të vlerës nominale të pullave për letrat deri në 20 gram për secilën dërgesë postare në trafikun postar vendas dhe ndërkombëtar përveç dërgesave për libra dhe revista.

Kompensimi nga paragrafi 2 i këtij neni, bëhet nga ana e Shoqatës akcionare për trafikun postal "Posta e Maqedonisë" – në pronësi të shtetit – Shkup dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare, në përputhje me ligjin.

Shoqata akcionare për trafikun postal “Posta e Maqedonisë” – në pronësi të shtetit – Shkup dhe ofruesit tjerë të shërbimit postar, të hollat e mbledhura nga kompensimi i përmendur i nenit 2 të

këtij neni bëjnë pagesën në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes të manifestimit në llogari të Kryqit të Kuq.

Kryqi i Kuq me një akt përcakton ditët kur organizohen veprimet dhe manifestimet nga paragrafi 1 të këtij neni.

#### Neni 29

Republika siguron fonde nga buxheti i saj për Shërbimin e kërkesave dhe për detyrat programore, të cilat Kryqi i Kuq i kryen në përputhje me nenin 19 pikat 1, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

Në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni, njësitë e vetqeverisjes lokale dhe qyteti i Shkupit nga buxhetet e tyre, përkatësisht sigurojnë fonde për organizatat e Kryqit të Kuq të komunave dhe qytetit të Shkupit në Republikën e Maqedonisë.

### VI. MBIKQYRJA

#### Neni 30

Mbikqyrja mbi kryerjen e detyrimeve nga nenet 27, 27-a, 28 dhe 29 të këtij ligji, në lidhje me mbledhjen dhe pagesën e kompensimeve kryhet nga organet kompetente që mbikqyrin punën e personave juridikë nga nenet 27, 27-a, 28 dhe 29 të këtij ligji.

#### Neni 31

Kryqi i Kuq organeve kompetente për mbikqyrjen e këtij ligji mund tju propozojë masa të rëndësishme për përdorimin e duhur të amblemës të Kryqit të Kuq dhe parandalimit për abuzimin e tij.

#### Neni 32

Organet kompetente kanë të drejtë dhe obligim në mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji:

- 1) të urdhërojë heqjen e amblemës së kryqit të kuq që përdoret, d.m.th që kryhet në kundërshtim me kushtet e miratuara në bazë të këtij ligji;
- 2) të urdhërojë masa tjera të nevojshme për zbatimin e këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të këtij ligji dhe
- 3) në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ti paraqesë organit kompetent një kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

## Neni 33

Njohja e popullatës të Republikës së Maqedonisë me tekstin e Konventave të Gjenevës të përmendura në nenin 19 pika 5 të këtij ligji kryhet nga Kryqi i Kuq.

Njohja e personave në forcat e armatosura të Republikës së Maqedonisë dhe punëtorëve në organizatat shëndetësore, përkatësisht institucionet me tekstin e Konventave të Gjenevës do të kryhen nga organet kompetente në forcat e armatosura, pra nga organizatat shëndetësore ose institucionet.

Njohja e studentëve të fakulteteve dhe Univerzitetit me tekstin e Konventave të Gjenevës do të bëhet në një mënyrë dhe me një procedurë të përcaktuar me rregulloret e organit të administratës shtetërore përgjegjëse për arsim.

## VII. DISPOZITA NDËSHKUESE

### Neni 34

Gjobë në vlerë prej 3,000 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet personit juridik nëse nuk mbledh dhe paguan përfitimet në favor të Kryqit të Kuq dhe nuk dorëzon Raport mujor deri te Kryqi i kuq, në përputhje me nenet 27, 27-a dhe 28 të këtij ligji.

Gjobë në vlerë prej 30% të gjobës së matur për personin juridik i shqiptohet kundërvajtje për veprimet nga paragrafi 1 I këtij neni dhe personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë në vlerë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet zyrtarit në personin juridik për veprimet nga paragrafi 1 të këtij neni.

### Neni 35

Gjobë në vlerë prej 5.000 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet personit juridik i cili përdor emrin e Kryqit të kuq pa autorizim në kundërshtim me nenin 9 të këtij ligji.

Gjobë në vlerë prej 30% të gjobës së matur për personin juridik do të shqiptohet kundërvajtje për veprimet nga neni 1 të këtij ligji.

### Neni 36

Gjobë në vlerë prej 150-300 euro në kundërvlerë të denarit do të shqiptohet kundërvajtje personit fizik:

1) nëse në gjendje të jashtëzakonsjme dhe gjendje lufte e mban apo e shfrytëzon emblemën e Kryqit të Kuq si emblemë mbrojtëse dhe nuk I përputhet nenit 13 paragrafit 1 të këtij ligji dhe

2) nëse gjatë shërbimit ai nuk e ka kartelën e identifikimit të përmendur në nenin 15 të këtij ligji ose nëse nuk e vesh shiritin me emblemën e Kryqit të Kuq në mënyrën e përcaktuar ose e humb statusin e një personi në bazë të të cilit ai mori kartelën e identifikimit dhe shiritin, dhe nuk ia kthen organit kompetent (neni 16).

#### Neni 36-a

Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj, zhvillohet një procedure kundërvatëse dhe shqiptohet sanksion kundërvajtës nga gjykata kompetente.

### VIII. DISPOZITAT MBARUESE

#### Neni 37

Autorizohet ministri i mbrojtjes ta përshkruajë mënyrën e përcaktimit të emblemës të Kryqit të Kuq për njësitë sanitare ushtarake dhe institucioneve, ndërtesave, paisjeve, materialeve sanitare dhe mjeteve transportuese që janë pjesë e shërbimit sanitare të forcave të armatosura të Republikës së Maqedonisë dhe ti përcaktojë trupat e forcave të armatosura që mund të kufizojnë përdorimin, gjegjësisht mbajtjen e emblemës së Kryqit të Kuq si emblemë mbrojtëse e njësisve sanitare ushtarake dhe institucioneve, si dhe organeve të forcave të armatosura që do të kujdesen për shfrytëzimin atyre rregulloreve.

#### Neni 38

Kryqi i Kuq rregullon përdorimin e emblemës dhe emrin e Kryqit të Kuq në kryerjen e veprimtarive të tij (nenet 9 dhe 11)

#### Neni 39

Organi i administratës shtetërore përgjegjës për çështjet e shëndetësisë, me propozimin e Kryqit të Kuq miraton rregullore:

- 1) për mënyrën e përdorimit të emblemës së Kryqit të Kuq, si emblemë e shënimit të emblemës së mbrojtjes (nenet 10 dhe 13) dhe
- 2) identifikimin dhe shiritin e përdoruesve të emblemës të Kryqit të Kuq në gjendje të jahtëzakonshme dhe gjendje lufte dhe për mbajtjen e evidencës për shiritat dhe lentat e lëshuara.

#### Neni 40

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, pushojnë të vlejnë Ligji për pozicion dhe autorizimi I Kryqit të Kuq të Maqedonisë(“Gazeta zyrtare I RMV-së” nr.27/77, 3/85, 10/85, 51/88, 28/89 dhe 23/91), Ligji për pozicionin dhe autorizimin e Kryqit të Kuq të Jugosllavisë(Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr.13/76) dhe Ligji për përdorimin dhe mbrojtjen e shenjës dhe emrit të Kryqit të Kuq(“Gazeta zyrtare e RSFJ-së “nr.13/82 dhe 24/88).

#### Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”